



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2381 Prot.

Lezhë, më 01.03.2021

V E N D I M

Nr. 42, Datë 24 / 02 / 2021

“ Për miratim të listës paraprake të pronave të paluajtshme që kërkohet të transferohet në pronësi të Bashkisë Lezhë.”

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2 gërma a, në ligjin nr. 8743 datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit” neni 8, i ndryshuar, në ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 2, neni 4, neni 6, neni 7, neni 8, neni 9, neni 11, neni 12, në ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” seksioni IV, në ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Kreu IV, Kreu V, kreu VII, në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shetërore”, neni 24, në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (i ndryshuar), në Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” si dhe në Udhëzimin nr 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore”, duke qenë se ky proces është i papërfunduar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pjeshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohen në pronësi apo përdorim të Njësisë Administrative Kallmet - Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.
 - a. Lista e inventarit bashkëngjitur, fshati Kallmet i Madh, Nj. A. Kallmet, Bashkia Lezhë.
2. Paraqitjen e listës së pjeshme paraprake për miratim në Këshillin e Ministrave.
3. Ngarkohet Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

